



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 40

Tiranë – E hënë, 21 tetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 354, datë 4.10.2019	Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit 3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 3345, datë 14.10.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Tofik Bodini” 5
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 3346, datë 14.10.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Lulzim Likalli” 6
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1275, datë 15.10.2019	Për shitje me ankand të pronave shtetërore, në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara 7
Kërkesë e Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 3753/1, datë 18.10.2019	Për rihapjen e procesit, për shprehjen e interesit, për t’u përzgjedhur si kandidat që do t’i propozohet Kuvendit të Shqipërisë, për t’u zgjedhur në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës.... 8
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5401, datë 22.7.2019	Për përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k. 9



URDHËR

Nr. 354, datë 4.10.2019

**PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pikës 1, të nenit 25, të nenit 26 dhe pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 25/2018, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe të nenit 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit” (VKM nr. 505);

Me qëllim, përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), sipas procedurave të përcaktuara në nenin 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KKK-së, që propozohet nga:

a) shoqatat profesionale të kontabilitetit: 1 (një) anëtar;

b) dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave: 1 (një) anëtar.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të KKK-së, sipas pikës 1 të këtij urdhri, kryhet nga një komision *ad hoc*, i cili përbëhet nga:

- z. Arian Kraja, Sek. i Përgj./MFE, kryetar;

- znj. Drinalda Ajazi, Përgj. i Sek./MFE, anëtar;

- znj. Evis Dino, Sek. i Përgj./UDHT, anëtar, dhe kryen këto detyra:

- njofton fillimin e procedurave (konkurrit) të përzgjedhjes së kandidatëve të përcaktuar në pikën 1 të urdhrit;

- shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe bën vlerësimin e kandidatëve, sipas mënyrës bazuar në kërkesat e posaçme të

parashikuara në nenin 3 të rregullores së organizimit dhe të funksionimit të KKK-së, miratuar me VKM-në nr. 505;

- harton listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë urdhër, të shoqëruar me një relacion përmbledhës së bashku me rekomandimin për kandidatët e përzgjedhur;

- i rekomandon ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për miratim, listën e kandidatëve të përzgjedhur.

3. Njoftimi i konkurrit për anëtar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, përmban të dhënat, si më poshtë:

a) një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që mbulon, do të mbulojë anëtar;

b) kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

d) mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

4. Kandidatët, që do të aplikojnë sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);

c) Curriculum vitae;

d) rekomandime që vërtetojnë figurën e pastër morale dhe autoritetin profesional të kandidatit;

e) kopje të noterizuar të librezës së punës;

f) kopje të noterizuar të diplomës;

g) kopje të noterizuara të dëshmive e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;

h) dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “g”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit.



6. Afati i shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësimit, hartimit të listës së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e posaçme dhe të relacionit përkatës, si dhe paraqitja e listës për miratim nga ministri i MFE-së, kryhet nga komisioni *ad hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit.

7. Përzgjedhja e kandidatëve nga komisioni *ad hoc* do të bëhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët pranë MFE-së, duke vlerësuar:

- a) arsimi: 35 pikë;
- b) përvoja profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor: 35 pikë;
- c) kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor: 30 pikë;

8. Fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KKK-së që propozohet nga:

- a) organizata profesionale e auditimit ligjor: 1 (një) anëtar;
- b) ministria përgjegjëse për financat (MFE), ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave: 3 (tre) anëtarë;
- c) Bordi i Mbikëqyrjes Publike: 1 (një) anëtar.

9. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet, sipas pikës 8 të këtij urdhri, institucionet përkatëse respektive duhet të paraqesin drejtpërdrejt kandidaturat pranë MFE-së, brenda 15 ditëve

nga data e shpalljes së këtij urdhri. Këto institucione janë përgjegjëse për plotësimin, nga kandidaturat e paraqitura për miratim nga ministri përgjegjës për financat, të kërkesave të posaçme, të parashikuara në pikën 10 të këtij urdhri.

10. Kërkesat e posaçme, që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i këshillit, janë si më poshtë vijojnë:

- a) të ketë edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose të financës;
- b) të jetë ekspert në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit (me titull/gradë) dhe, të paktën, 5 (pesë) vitet e fundit të jetë i përfshirë drejtpërdrejt në këtë fushë; ose praktikues i licencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 10 (dhjetë) vitesh; ose praktikues i palicencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh;
- c) të ketë figurë të pastër morale dhe autoritet të njohur profesional.

11. Ministri i MFE-së, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune, miraton anëtarët e KKK-së, nga lista e kandidatëve të propozuar, sipas pikave 1 dhe 8 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

**KËRKESË****Nr. 3345, datë 14.10.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “TOFIK BODINI”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- Tofik Bodini

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DËTYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000722-5

Datë 6.9.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000722-2, datë 4.9.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin Tofik Xhemal Bodini, NIPT H60412195K, përfaqësues i autorizuar i subjektit Tofik Bodini, prej datës 3.9.2019, ora 20:50 deri në datën 4.9.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 4.9.2019 dhe e njoftoi në datën 6.9.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, neni 38, pika 1, germa “o”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit

Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 80 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Sekuestrimi i sasisë prej 8 mst dru zjarri, pranë pikës së miratuar të Bashkisë Tiranë.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

- Shtetasi Tofik Bodini nuk duhet të transportojë asnjëherë material drusor pa dokumentacion ligjor.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Dashamir Koltraka ID: 0301010009

Ervin Hysa ID: 0301010021

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti Tofik Xhemal Bodini ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË****Nr. 3346, datë 14.10.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “LULZIM LIKALLI”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të Komisionit të Ankimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- Lulzim Likalli

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DEJTYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

**VENDIM
I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 000075-5, datë 21.1.2019, të ISHMPUT Tiranë**, ndaj subjektit **Lulzim Likalli**, protokolluar me nr. 3465, datë 11.4.2019 dhe 1390 prot., datë 13.2.2019,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me nenin 38, pikën “o”, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 000075-5, datë 21.1.2019, në vlerën 80.000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.



NJOFTIM
Nr. 1275, datë 15.10.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONAVE SHTETËRORE, NË
ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË
SEKUESTRUARA DHE TË
KONFISKUARA**

përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009”, si më poshtë:

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 23.7.2010, “Për

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë arë	Sauk, Tiranë	2 307 500	0	2 307 500	355	0	13.11.2019	10:00	DDPP

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë arë	Sauk, Tiranë	1 577 700	0	1 577 700	1 200	0	13.11.2019	10:30	DDPP

3. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë arë	Sauk, Tiranë	624 000	0	624 000	96	0	13.11.2019	11:00	DDPP

4. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1.	Apartament 2+1	Rr. “Muhamet Gjollështa”, Tiranë	9 430 000			80.6		13.11.2019	11:30	DDPP

5. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1.	Apartament 2+1	Rr. “Muhamet Gjollështa”, Tiranë	9 640 000			82.4		13.11.2019	12:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare**, në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

KËRKESË

Nr. 3753/1, datë 18.10.2019

PËR RIHAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT, PËR T'U PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T'I PROPOZOHEK KUVENDIT TË SHQIPËRISË, PËR T'U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË AUTORITETIN E KONKURRENCËS

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë **nr. 3092/1 prot.**, datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të

Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent, për të siguruar përzgjedhjen e kandidatit/tëve me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion, vendosi:

Hapjen e procesit për çdo të interesuar, që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.

Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9121/2003, Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen nga Kuvendi, **me kandidatura alternative**, ku një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës.

Shpallja dhe administrimi i kandidaturave qëndroi i hapur për një afat 10-ditor, nga data 23 shtator–3 tetor 2019.

Në vlerësim të faktit, se brenda afatit të shpallur për aplikim nuk u siguria numri i nevojshëm i kandidatëve, për të përzgjedhur ndërmjet tyre kandidaturat alternative të përshtatshme për t'iu propozuar Kuvendit, Presidenti i Republikës ka vendosur: **Rishpalljen e procesit për shprehjen e interesit, për t'u përzgjedhur si kandidat që do t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë, për t'u zgjedhur në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës.**

Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë nga data e sotme 18 tetor deri në datën 25 tetor 2019, ora 12:00.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, që të marrë pjesë në këtë proces publik e të shprehë interesin për të qenë kandidat për anëtar të Komisionit të Konkurrencës, të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën për shprehjen e interesit;
- jetëshkrimin në gjuhën shqipe me të dhënat e plota të kontaktit;



- kopje të noterizuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve për t'u zgjedhur në këtë pozicion, të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;
- të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti "E drejtë civile/administrative";
- të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në mjediset e selisë së Presidentit, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista totale e personave, të cilët kanë shprehur interesin do të bëhet publike në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Kandidatëve të përzgjedhur do t'u kërkohej paraqitja e dokumentacionit shtesë si më poshtë:

- formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar dhe nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- formularin e aplikimit, të plotësuar: "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

- vetëdeklarim i aplikantit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit, sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

Propozimi, që Presidenti i Republikës do t'i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

VENDIM

Nr. 5401, datë 22.7.2019

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË "VAPORUSA ALB" SHPK

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Alma Kodraliu, gjyqtare,

me sekretare gjyqësore Eva Topollari, në Tiranë, sot në datën 22.7.2019, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile-tregtare, që i përket:

KËRKUES: Administratorja e falimentit Anida Nuri.

OBJEKTI: Kërkesë për përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë "Vaporusa Alb" sh.p.k. Bazuar në ligjin nr. 8901/2002, "Për falimentimin", i ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901/2002, "Për falimentimin", i ndryshuar.

VËREN:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 18 maj 2016, ka vendosur:

"1. Pranimin e kërkesës së kërkuessit, shoqëria "Valsir" s.p.a., me seli në Vestone Itali, si e mbështetur në ligj dhe në prova. Të deklarojë të hapur procedurën e falimentimit për shkak të paafësisë paguese, ndaj debitorit shoqëria "Vaporusa Alb" sh.p.k. me NUIS K51625022G, me adresë: Kashar, autostrada Tiranë-Durrës, rruga dytësore, km 5, me administrator Franco Foresti dhe fushë të veprimtarisë: Tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksporti dhe distribucioni i materialeve dhe i pajisjeve për impiante teknologjike, mekanike, kondicionimi, ventilimi etj.". Koha e deklarimit të hapjes së procedurës së falimentimit është ora 09:55, datë 22 tetor 2015. Emërimin si administratore të licencuar të falimentimit, për shoqërinë "Vaporusa Alb" sh.p.k., të znj. Anida Nuri, me adresë: rruga "Bab Rexha", pallati nr. 10/1, ap. 27 Tiranë..."

2. Procedura e falimentimit është çelur me kërkesën e shoqërisë "Valsir" s.p.a., e cila ka mbuluar dhe shpenzimet e hapjes dhe të mbajtjes së procedurës së falimentimit, përmes depozitimit të shumës përkatëse në llogarinë e administratorës, të shumës 998 980 euro, shumë



e cila është përdorur për shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe për shpërndarjen e parë. Nga ana e administratores, janë marrë masat për shpërndarjen e parë të masës së falimentimit dhe mbledhjen e masës së falimentimit. Për këtë qëllim, nga ana e saj janë marrë masat për fillimin dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë në falimentim.

3. Në raportimin e datës 1.11.2018, nga ana e administratores së falimentimit është sqaruar se janë përfunduar procedurat e falimentimit, verifikimi i pretendimeve, çështjet gjyqësore dhe procedura përbarimore e mbledhjes së detyrimeve të debitorëve të shoqërisë në falimentim “Vaporusa Alb” sh.p.k. Sipas administratores, këto llogari të arkëtueshme, janë e vetmja masë falimentimi që është gjendur në datën e hapjes së procedurave të falimentimit dhe masa e falimentimit është realizuar nga mbledhja nëpërmjet procedurave përbarimore të debitorëve, sipas listës së përpiluar nga ekspertja.

4. Konkretisht, deri në këtë datë, sipas administratores së falimentimit, nga shuma 43 390 989 lekë masë falimentimi, janë arkëtuar 8 897 056 lekë, shumë nga e cila janë kthyer shumat përkatëse nga debitorët (“Beair Techonology” sh.p.k., “Haki Sinani” sh.p.k. dhe “Hidrotech” sh.p.k., bazuar në vendimet e gjykatës). Sipas administratores së falimentimit, sipas raportimit të kësaj date, kanë përfunduar çështjet gjyqësore me debitorët e shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k., dhe në favor të shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k. ka përfunduar vetëm çështja me shoqërinë “Art Konstruksion” sh.p.k. Në këtë datë, sipas raportit të përpiluar nga ana e administratores së falimentimit, gjendja aktuale e mjeteve monetare në bankë është 1 293 808, 29 lekë, të cilat sipas saj mund të përdoren për shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe për një shpërndarje të fundit.

5. Ndërkohë, me vendimin e datës 17.12.2018, Komiteti i Kreditorëve ka vendosur shpërndarjen e dytë të masës së falimentimit, duke shlyer kreditorët e radhëve të para të preferimit. Në rastin konkret, sipas këtij vendimi, është shlyer kreditori, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë.

6. Me vendimin e datës 17.1.2019, mbledhja e Komitetit të Kreditorëve ka vendosur miratimin e raportit përfundimtar të procedurës së

falimentimit të përgatitur nga administratorja e falimentimit. Ndërkohë, nga ana e gjykatës janë njoftuar kreditorët e tjerë për pamjaftueshmërinë e masës së falimentimit për kryerjen e shpërndarjeve të tjera. Në seancën e datës 18.1.2019, në vend të kreditorit “Banka Veneto” sh.a. është paraqitur shoqëria “Societa per la Gestione di Attività” (më tutje “S.G.A.” s.p.a.), e cila ka paraqitur një kërkesë për kryerjen e kalimit procedural. Kjo, për shkak se personi i tretë në këtë gjykim, shoqëria “Veneto Bank” sh.a., ka ceduar kreditë e saj te shoqëria “S.G.A.” s.p.a., duke listuar ndër këto kredi edhe kredinë te shoqëria “Vaporusa Alb” sh.p.k. Në kushtet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këtë kredi kanë kaluar te shoqëria “S.G.A.” s.p.a., është vendosur kalimi procedural dhe në vend të shoqërisë “Veneto Bank” sh.a., me cilësinë e personit të tretë, ka hyrë në proces shoqëria “S.G.A.” s.p.a.

7. Ndërkohë, shoqëria “S.G.A.” s.p.a., pasi është njohur me fashikullin gjyqësor, në seancën pasardhëse ka kërkuar thellimin e hetimit lidhur me ortakët e shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k., mbi veprimet e kryera prej tyre, pasi sipas nenit 16 të ligjit për falimentimin, ata kanë pasur dëjani për paaftësinë paguese të shoqërisë dhe duke mos paraqitur kërkesë në gjykatë për çeljen e procedurave të falimentimit, janë personalisht përgjegjës. Ndërkohë, nga ana e administratores dhe përfaqësuesve të kreditorëve të tjerë, është sqaruar se në Prokurorinë e Tiranës është paraqitur kallëzimi penal lidhur me këtë çështje. Nisur nga fakti se pala kreditore, shoqëria “S.G.A.” s.p.a., ka pretenduar mosmarrjen e të dhënave lidhur me kallëzimin penal, nga ana e gjykatës, në seancën e datës 19.3.2019 është vendosur t’i drejtohet Prokurorisë së Tiranës, me qëllim marrjen e një informacioni nëse është hetuar për tërheqjen e pajustificuar të shumave nga llogaria e shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k nga ana e ish-administratorit Enkelejd Saliaj dhe në çfarë faze ndodhen çështja penale në lidhje me shoqërinë “Vaporusa Alb” sh.p.k. Megjithëse nga ana e gjykatës janë shtyrë edhe dy seanca të tjera, me qëllim marrjen e një informacioni të tillë nga ana e Prokurorisë së Tiranës, kjo e fundit nuk ka depozituar informacionin e kërkuar.

8. Megjithatë, në kushtet kur fati i procedurës së falimentimit nuk varej nga përfundimi i



çështjes penale, gjykata revokoi vendimin për marrjen e informacionit nga Prokuroria dhe mori në shqyrtim kërkesën për mbylljen e procedurës së falimentimit. Nga ana e Komitetit të Kreditorëve, në seancën e datës 20.6.2019, u kërkuar kohë, pasi anëtarët e Komitetit të Kreditorëve nuk kishin arritur në një përfundim nëse procedura e falimentimit duhej mbyllur apo duhej ndërprerë. Më tej, në seancën e datës 11.7.2019, lidhur me kërkesën e administratorës për përfundimin e procedurës së falimentimit, shumica e Komitetit të Kreditorëve kërkoi që gjykata të mbyllë procedurën e falimentimit, për shkak se deri në këtë fazë janë ezauruar të gjitha rrugët dhe procedurat e ndjekura që parashikon ligji për procedurën e falimentit dhe nisur nga fakti se nuk ka më asete që mund të mblidhen, procedura e falimentimit duhet mbyllur.

9. Përfaqësuesi i shoqërisë “S.G.A.” s.p.a. kërkoi përfundimin e procedurës së falimentimit me anë të ndërprerjes së saj dhe jo mbylljes, për shkak se, sipas tij, Komiteti i Kreditorëve nuk ka legjitimitet në procesin e votimit. Po kështu, për shkak se sipas pikës 1, të nenin 2, të ligjit për falimentimin, nuk është duke u shlyer detyrimi i debitorit ndaj kreditorëve dhe se Komiteti i Kreditorëve po shkarkon nga pjesa e mbetur e detyrimeve debitorin “Vaporusa Alb” sh.p.k., në një kohë kur administratorja e falimentimit ka

inicuar një proces penal mbi veprimet e ndjekura nga kjo shoqëri në administrimin e saj. Referuar neneve 14 dhe 16, të ligjit për falimentimin, ortakët e shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k., duhet të përgjigjen personalisht për mosveprimin, pasi kanë pasur dijeni për gjendjen e shoqërisë. Në këto kushte, me mbylljen e procedurës “fallen” apo “amnistohen” detyrimet e shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k. kundrejt kreditorëve të saj. Sipas kreditorit “S.G.A.” s.p.a., me mbylljen e procedurës së falimentimit, debitori dhe ortakët/ish-administratorët e shoqërisë, nuk mbajnë më asnjë përgjegjësi ligjore dhe financiare kundrejt debitorëve, ndërkohë që vetëm ndaj shoqërisë “S.G.A.” s.p.a., shoqëria në falimentim ka 405 007 euro detyrime, ndërkohë që edhe garancitë hipotekore për detyrimin që debitori ka ndaj nesh nuk ekzistojnë më. Në kushtet kur masa e falimentimit nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe detyrimet e tjera, sipas nenit 171, kjo procedurë falimentimi duhet ndërprerë, duke u mbështetur në nenet 170–177, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar.

10. Lidhur me tabelën e kreditorëve të falimentimit ata paraqiten si më poshtë, sipas pretendimeve të vërtetuara, pagesave të kryera si dhe kreditorët që kanë mbetur pa u paguar.

Nr.	Emërtimi i kreditorit	Preferenca sipas nenit 605 të K. Civil	Pretendimet e vërtetuara në lekë (neni 145)	Pagesat për kreditorët	Kreditorët e papaguar
1	“Albtelecom” sh.a.		338 716		338 716
2	“Albtelecom” sh.a.		45 012		45 012
3	Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë	DH)	13 990 263	272 441	13 717 822
4	Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë		1 425 635		1 425 635
5	“Porche Albania” sh.p.k.		189 534		189 534
6	“Vodafone” sh.a.		119 471		119 471
7	Ervina Serani	B)	133 200	133 200	Nuk ka
8	S.G.A. s.p.a.		51 285 395		51 285 395
9	“Prandelli” sh.p.k.		8 587 225		8 587 225
10	“Valsir” s.p.a.		7 699 271		7 699 271
	TOTALI		83 813 722	405 641	83 408 081

11. Pasi dëgjoi administratoren e falimentimit dhe përfaqësuesit e kreditorëve, gjykata vëren se procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë pagueuse apo të mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin

e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

12. Qëllimi i procedurës së falimentit është shlyerja e kreditorëve të subjektit debitor dhe me qëllim shlyerjen e të gjithëve njëkohësisht dhe në mënyrë të drejtë, për shkak se ekzekutimi në mënyrë të veçantë për çdo kreditor, përveçse nuk



do të garantonte shlyerjen e të gjithë debitorëve, do të çonte në një shpërndarje jo të drejtë. Ky është në fakt edhe qëllimi i një procedure të tillë.

13. Çështja e cila shtrohet për diskutim në procedurën e mbylljes së falimentimit është nëse procedura duhet ndërprerë apo duhet mbyllur. Personi i tretë, shoqëria “S.G.A.” s.p.a., në qëndrimin e saj përfundimtar ka kundërshtuar vendimin e mbledhjes së kreditorëve. Megjithatë, duhet sqaruar se ky lloj vendimi shpreh thjesht qëndrimin e Komitetit të Kreditorëve ose, në rastin konkret, të një pjese të tyre dhe nuk ka vlerë detyruese për gjykatën, por është thjesht qëndrimi i tyre lidhur me përfundimin e procedurës, por është gjykata ajo, që duke pasur parasysh zhvillimin në tërësi të gjykimit, provat e administruara dhe legjislacionin në fuqi, vendos në lidhje me mënyrën e përfundimit të kësaj procedure falimentimi. Një rregullim të tillë parashikon neni 177/2, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “Para se të vendosë për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon palën kërkuese, administratorin e falimentimit dhe komitetin e kreditorëve, kur një i tillë është caktuar. Në rastin e kundërshtimit prej një kreditori, dëgjohet edhe kreditori i kundërshtuar.”.

14. Neni 163, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, parashikon se: “Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit bën mbylljen e procedurës së falimentimit.”. Neni 170, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “1. Në qoftë se pas fillimit të procedurës së falimentimit rezulton se masa e falimentimit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e ndërpret procedurën. Ndërprerja nuk bëhet kur parapaguhet një shumë e mjaftueshme. 2. Përpara vendimit për ndërprerje të procedurës së falimentimit dëgjohet mbledhja e kreditorëve, administratori dhe kreditorët e masës së falimentimit. 3. Administratori përdor çdo shumë në të holla, që gjendet në masën e falimentimit, për shlyerjen e shpenzimeve të procedurës. Së pari, paguben shpenzimet në përpjesëtim me shumën përkatëse para ndërprerjes së procedurës. Administratori nuk mban përgjegjësi të mëtejshme për disponimin e sendeve të masës së falimentimit.”. Neni 171, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “Njoftimi për pasuri të pamjaftueshme të masës së falimentimit: 1. Nëse mbulohen shpenzimet e procedurës së falimentimit, por pasuritë nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrime të tjera, të maturuara, të masës së

falimentimit, administratori i falimentimit njofton seksionin tregtar të gjykatës së rrethit për pamjaftueshmërinë e pasurive. E njëjta gjë vlen kur pasuritë parashikohen të jenë të pamjaftueshme për plotësimin e detyrimeve të tjera ekzistuese të masës së falimentimit në datën e maturimit. 2. Gjykata shpall publikisht njoftimin për pamjaftueshmëri të pasurive në masën e falimentimit. Njoftimi u bëhet individualisht kreditorëve të masës së falimentimit. 3. Detyra e administratorit për administrimin dhe për përdorimin e pasurive të masës së falimentimit vazhdon edhe pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive.”.

15. Neni 174, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ndërpret procedurën e falimentimit, pasi administratori i falimentimit ta këtë shpërndarë masën e falimentimit, sipas nenit 172 të këtij ligji. Administratori paraqet llogari të veçanta për veprimtarinë e vet, pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit. 2. Në qoftë se pas ndërprerjes së procedurës gjenden sende që formojnë pjesë të masës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori të masës, urdhëron shpërndarje të vonuar. Nenet 166, pika 3, 167 dhe 168, të këtij ligji, zbatohen sipas rastit.”. Neni 175, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “Me kërkesë të debitorit, procedura e falimentimit ndërpritet kur ai është në gjendje ta sigurojë gjykatën, se pas ndërprerjes, nuk do të jetë më i kërcënuar nga gjendja e paafësisë paguese ose falimentimi, në rast se procedura e falimentimit është hapur për shkak të paafësisë paguese. Një kërkesë e tillë pranohet nëse debitori tregon në gjykatë, në mënyrë bindëse, se nuk ka shkak për hapjen e procedurës së falimentimit.”. Neni 176, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: “1. Procedura e falimentimit ndërpritet me kërkesën e debitorit, kur ky, pasi përfundon periudha e njoftimit, paraqet një deklaratë miratimi të të gjithë kreditorëve të falimentimit, që kanë depozituar pretendime për ndërprerjen e kësaj procedure. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, sipas diskrecionit të saj, vendos për kreditorët, kërkesat e të cilëve janë kundërshtuar nga debitori ose administratori i falimentimit dhe për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, lidhur me kërkesat e miratimit të kreditorëve ose të mjeteve të sigurisë që ata dubet të paraqesin. 2. Procedura e falimentimit mund të ndërpritet me kërkesën e debitorit edhe përpara mbarimit të afatit të depozitimit, nëse gjykata nuk njeh kreditorë të tjerë, përveç kreditorëve për të cilët debitori ka paraqitur deklaratat e miratimit prej tyre.”.



16. Neni 177/2, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: *“Para se të vendosë për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon palën kërkuese, administratorin e falimentimit dhe komitetin e kreditorëve, kur një i tillë është caktuar. Në rastin e kundërshtimit prej një kreditori, dëgjohet edhe kreditori i kundërshtuar.”* Neni 178, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: *“1. Vendimi për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, sipas neneve 170, 174, 175 dhe 176 të këtij ligji, dhe shkaku për këtë ndërprerje shpallen publikisht. Debitori, administratori i falimentimit dhe anëtarët e komitetit të kreditorëve njoftohen më parë për datën e hyrjes në fuqi të ndërprerjes. 2. Me ndërprerjen e procedurës së falimentimit debitori rifiton të drejtën të disponojë lirisht për pasuritë e masës së falimentimit. Nenet 164 dhe 165, të këtij ligji, zbatohen sipas rastit.”* Neni 164, i ligjit nr. 8901/2002, parashikon se: *“1. Pas mbylljes së procedurës së falimentimit, kreditorët e falimentimit mund të kërkojnë pa kufizim plotësimin e pretendimeve të mbetura ndaj debitorit. 2. Kreditorët e falimentimit, që kanë ngritur pretendime të vërtetuara, të cilat nuk janë kundërshtuar nga debitori gjatë mbledhjes së verifikimit, mund të përmbushin këto pretendime ndaj debitorit me rrugë ekzekutimi ligjor, duke u bazuar në regjistrimin në tabelë, që ka të njëjtën vlerë si një vendim i ekzekutueshëm. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim ndaj të cilit kundërshtimi është hedhur poshtë. 3. Dispozitat për shkarkimin nga detyrimet e mbetura nuk cenohen.”*

17. Ndërprerja e një procedure falimenti ka kuptim kur hapet procedura dhe konstatohet që nuk ka masë falimenti dhe nuk shlyhen as shpenzimet e procedurës dhe kur kreditorët nuk financojnë mbajtjen e procedurës. Ose, ndërprerja e procedurës së falimentimit mund të bëhet me kërkesën e debitorit, kur është hapur procedura e falimentimit dhe debitori paraqet deklaratë miratimi të kreditorëve për ndërprerjen e procedurës së falimentimit. Ndërprerja me kërkesën e debitorit ka të bëjë me rastin kur shoqëria në falimentim ka aftësi paguese dhe mund të rimëkëmbet dhe paguajë borxhet. Duhet sjellë në vëmendje se me ndërprerjen e procedurës së falimentimit, debitori rifiton të drejtën të disponojë lirisht pasuritë e masës së falimentimit.

18. Në rastin konkret, procedura është hapur, janë likuiduar një pjesë e detyrimeve dhe nuk ka me ndonjë pritshmëri në drejtim të shlyerjes së

detyrimeve të tjera. Nuk ka kuptim që një shoqëri pa veprimtari ekonomike dhe pa asete të qëndrojnë në treg dhe që shoqëria të mund të vijojë aktivitetin ekonomik. Lënia në treg e një shoqërie të tillë do të dëmtonte tregun dhe interesat e personave të tretë që mund të hynin në marrëdhënie me të.

19. Sa më sipër, gjykata vlerëson se procedura e falimentimit duhet përfunduar me anë të mbylljes së saj. Ndërkohë, mbyllja nuk cenon interesat e kreditorëve, pasi këta të fundit, mund t'i realizojnë të drejtat e tyre edhe pas përfundimit të procedurës ndaj debitorëve. Neni 164 i ligjit, parashikon se: *“Pas mbylljes së procedurës së falimentimit, kreditorët e falimentimit mund të kërkojnë pa kufizim plotësimin e pretendimeve të mbetura ndaj debitorit. 2. Kreditorët e falimentimit, që kanë ngritur pretendime të vërtetuara, të cilat nuk janë kundërshtuar nga debitori gjatë mbledhjes së verifikimit, mund të përmbushin këto pretendime ndaj debitorit me rrugë ekzekutimi ligjor, duke u bazuar në regjistrimin në tabelë, që ka të njëjtën vlerë si një vendim i ekzekutueshëm. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim ndaj të cilit kundërshtimi është hedhur poshtë. 3. Dispozitat për shkarkimin nga detyrimet e mbetura nuk cenohen.”*

20. Sa më sipër, gjykata vlerëson se procedura e falimentimit duhet përfunduar me anë të mbylljes dhe jo të ndërprerjes së saj. Kreditorët e falimentimit mund të përmbushin këto pretendime ndaj debitorit me rrugë ekzekutimi ligjor, duke u bazuar në regjistrimin në tabelë, që ka të njëjtën vlerë si një vendim i ekzekutueshëm.

21. Në lidhje me shpenzimet e gjykit, gjykata evidenton vetëm shpenzimet e kryera për njoftime të ndryshme, në shumën 2 500 lekë. Shpenzime të tjera në këtë fazë nuk evidentohen dhe lihen siç janë kryer.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”, nenet 306–309, të K. Pr. Civile,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Vaporusa Alb” sh.p.k. dhe çregjistrimin e saj nga regjistri i shoqërive tregtare



që mbahet në QKB, me marrjen formë të prerë të vendimit.

2. Ngarkohet administratorja e falimentimit t'u njoftojë një kopje të këtij vendimi kreditorëve të shoqërisë.

3. Ky vendim publikohet në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, "Për falimentimin", në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Bizneseve dhe pranë organit tatimor përkatës, Drejtoria e Tatimeve Tiranë.

4. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, në datën 22.7.2019.

SEKRETARE
Eva Topollari

GJYQTARE
Ima Kodraliu

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019